



Arminda Bushi

Kryeauditues

KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Znj. Arminda Bushi ka përfunduar studimet e larta në vitin 2006 pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Gjithashtu, në vitin 2010-2011 ka kryer studimet pasuniversitare, "Master i nivelit të dytë" për të Drejtën Civile. Ajo gëzon titullin Avokat, nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë që prej vitit 2009.

Znj. Bushi është certifikuar si Auditues i Brendshëm i Sektorit Publik në vitin 2011.

Ajo ka një eksperiencë prej 18 vitesh në auditim. Prej tetorit të vitit 2006 e në vazhdim, ka punuar pranë KLSH në pozicione si Juriste në Departamentin Juridik dhe Sigurimin e Cilësisë, Audituese e Parë në Departamentin e Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, Audituese e Parë në Departamentin e Metodologjisë dhe Trajnimeve, Audituese e Lartë në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja si dhe në Departamentin e Auditimit të Performancës. Përgjatë viteve ka qenë në rolin e përgjegjëses së grupeve të auditimit me fokus kryerjen e auditimeve të Përputhshmërisë dhe të Performancës.

Aktualisht Znj. Bushi ushtron detyrën e "Kryeauditueses" në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore, në Kontrollin e Lartë të Shtetit.


Gjatë eksperiencës profesionale është angazhuar në një sërë trajnimesh, konferencash, seminare, brenda dhe jashtë vendit në lidhje me çështje të auditimit të jashtëm në sektorin publik, antikorrupsionin dhe prokurimin publik, gjurmimin e mashtrimit dhe korrupsionit, etj., të organizuara nga institucione të ndryshme apo SAI-e të tjera, si dhe është pajisur me certifikatat përkatëse.


Përgjatë karrierës ka shërbyer si trajnere në disa tema për Auditimin e Performancës si dhe ka publikuar në mediane e shkruar mbi rëndësinë e komunikimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit, medias dhe qytetarëve.


Znj. Bushi është njohëse shumë e mirë e gjuhës italiane dhe gjuhës angleze.



Kontakt

 abushi@klsh.org.al

 Rruga "Abdi Toptani", Tiranë
Shqipëri

 www.klsh.org.al